




Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	19. 01	702	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SLIPMSHUK	215/2021		119	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.396/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.396/2020 të datës 07.12.2020 e parashtruar nga ankuesi me adresë fshati "Rogaçicë", Komuna e Kamenicës, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.396/2020 e datës 07.12.2020 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, në bazë të autorizimit të datës 10.09.2019 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, me datën 14.09.2019 ka shpallur konkurs për rekrutimin e pozitës "Asistent administrativ" në Qendrën e regjistrimit të automjeteve në Kamenicë, i cili konkurs është vazhduar edhe për shtatë (7) dite të tjera nga data 05.10.2019 deri me 11.10.2019, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe kandidati

Me datën 11.09.2019 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria e Administratës Publike me datë 07.10.2019, ka njoftuar të gjitha institucionet publike për hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrtarë Publik dhe ka udhëzuar që të

gjitha procedurat e konkurseve të cilat janë shpallur sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të pezullohen përkohësisht. Bazuar në këtë njoftim, Ministria e Punëve të Brendshme me datë 08.10.2019 përmes shkrësës Nr.782/19 të publikuar në webfaqe të Ministrisë, ka njoftuar së është pezulluar procedura e rekrutimit për pozitën "Asistent administrativ", në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Kamenicë.

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me datë 25.11.2019 është pezulluar me vendimin Nr. ref.:VVMP 1525/20 për Masë të Përkohshme nga Gjykata Kushtetuese. Pas vendosjes së masës së përkohshme të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ministria e Administratës Publike me datë 10.01.2020, ka lëshuar njoftimin me shkrim dhe ka udhëzuar të gjitha institucionet publike që ti aplikojnë dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil. Bazuar në këtë njoftim, Ministria e Punëve të Brendshme ka vazhduar procedurën e pezulluar për rekrutimin e pozitës "Asistent administrativ", në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Kamenicë, ku ka themeluar Komisionin Përzgjedhës, ka organizuar testin me shkrim, intervistën me gojë dhe në tërësi ka përfunduar procedurën e rekrutimit me datë 03.03.2020 përmes publikimit të njoftimit për kandidatin e suksesshëm

Me datën 17.06.2020 U.d. e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme ka nxjerr Vendimin Nr.466 me të cilin ka anuluar konkursin e datës 14.09.2019, me arsyetimin se Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administratës Publike preken nga procesi i fuzionimit apo bashkimit sipas Vendimit nr. 07-v-005 të datës 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe me arsyetimin se procedura e listës së ngushte është bërë jashtë afatit prej 5 dite të përcaktuar me Rregulloren për Procedurat e Rekrutimit.

Ankuesi, kundër njoftimit për anulimin e konkursit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datën 07.12.2020 ,ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2988/2020 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 14.12.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme. Ministria e Punëve të Brendshme me datën 24.12.2020, ka përcjell dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Me datën 14.01.2021 nëpërmjet e-mailit zyrtar kemi kërkuar nga znj. Udhëheqëse e Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, *nëse ankuesi ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave apo në Ministri, dhe përgjigja me datë 15.01.2021 nga Mirjeta Krasniqi-Zyrtare e lartë e burimeve njerëzore, në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka qenë që: "kandidati nuk ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe as në Ministrinë e Punëve të Brendshme".*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:




Ankesën me numër protokollit 2988/2020 të datës 07.12.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetim mbi pranimin e aplikacionit të ankuesit nga Ministria e Infrastrukturës 07.12.2020; Kërkesë e datës 31.10.2019; Njoftim për anulim të konkursit i datës 18.06.2020; Njoftim për kandidatin e suksesshëm i datës 03.03.2020; Kërkesa për punësim e datës 27.09.2019 e ankuesit me shkresat e bashkangjitura; Raport përmbledhës i datës 25.02.2020 nga Ministria e Punëve të Brendshme për pozitën "Asistent administrativ" në QRA -Kamenice; Lista e ngushte e aplikantëve për interviste me gojë e datës 24.02.2020; Lista me emrat e aplikantëve që kanë hyre në testin me shkrim e datës 14.02.2020; Intervista me gojë e datës 24.02.2020; Përcaktimi i kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-07a; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushte Form.MAP-SHCK-05; Njoftim i datës 03.03.2020 për kandidatin e suksesshëm; Vendim për themelimin e komisionit përzgjedhës të shërbimit civil i datës 05.02.2020; Regjistri i aplikacioneve të listës së ngushte i datës 10.02.2020; Regjistri i aplikacioneve të listës së gjere; Testi me shkrim i datës 14.02.2020; Autorizim i MAP për shpalljen e konkursit i datës 10.09.2019; Konkurs i datës 14.09.2019; Vazhdim i afatit të konkursit i datës 28.09.2019; Vendim për anulim të konkursit i datës 17.06.2020; Kërkesë e ankuesit e datës 14.01.2021; Kërkesa për përgjigje në ankese e datës 14.12.2020; Përgjigja në ankese e datës 29.12.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit **është bërë i pamundur**, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi me datën 07.12.2020, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa me datën 14.01.2021, ka parashtruar kërkesë me numër të protokollit 142/2021, me të cilën ka deklaruar se e tërheq ankesën e datës 07.12.2020, me arsyetimin se KPMSHCK ka anuluar vendimin me numër Nr.466 të datës 17.06.2020 të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të kësaj rrethane, konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejte e palës e përcaktuar me dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se : "*Një procedure administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*", andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.396/2020

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

